

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil,** Gjyqtarja Mirvete Alidemi në çështjen kontestimore të paditësit A.S. nga ..., Rr.” ... ”, nr.73, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.A., avokat nga ..., e paraqitur ndaj të paditurve: S.D. nga ..., T.S. dhe M.R. të tre tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm A.S., avokat nga ..., me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, me datë 13 Korrik 2018, gjykata mori dhe shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** si e bazuar në ligj padia dhe kërkesëpadia e paditësit A.S. nga ..., e paraqitur ndaj të paditurve: S.D. nga ..., T.S. dhe M.R. të tre tani me adresë të panjohur dhe

**VËRTETOHET** se paditësi në bazë të kontratës së shitblerjes në vitin 1972 dhe në bazë të mbajtjes është pronarë i ngastrës kadastrale me numër ..., në vendin e quajtur “ ... “, me kulturë shtëpi-oborr, në sipërfaqe prej 290 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet sipas Qertifikatës Pronësore me numër të lëndës ..., të dt.13.03.2015, ZK Gjilan, në emër të të paditurve si bashkëpronarë edhe ate: S.D. në pjesën ideale 16/30, T.S. në pjesën ideale 7/30 dhe M.R. në pjesën ideale 7/30.

**DETYROHEN** të paditurit S.D. nga ..., T.S. dhe M.R. të tre tani me adresë të panjohur, që t’ia njohë këtë të drejtë paditësit dhe të përmbahen dhe të durojnë që paditësi në bazë të këtij aktgjykimi ta bartë këtë paluajtshmëri në emër të tij në DGJKP në Gjilan, këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

## **A r s y e t i m**

### **1. Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës**

**1.1.** Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje dhe bazuar në nenin 1 dhe 29 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK, lidhur me nenin 11.1 të Ligjit për Gjykatën e Kosovës, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur.

**1.2.** Kompetenca territoriale ekskluzive e gjykatës është përcaktuar konform nenit 41 të LPK-së, pasi që paluajtshmëria kontestuese gjendet në teritorin e Gjykatës Themelore në Gjilan.

**1.3.** Kompetenca lëndore është përcaktuar konform nenit 29 lidhur me nenin 17 të LPK-së, pasi që vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata, meqenëse kemi të bëjmë me një kontest me karakter civil që rrjedh nga

marrëdhëniet pronësore, gjykata çmon se është kompetentë nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështje.

## **2. Rrjedha e çështjes dhe pretendimet e palëve:**

**2.1.** Paditësi A.S. nga ..., përmes përfaqësuesit të tij me autorizim avokatit M.A. nga ..., në këtë gjykatë me dt.26.05.2015, ka paraqitur padi ndaj të paditurve: S.D. nga ..., T.S. dhe M.R. të tre tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të kontratës, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj dhe të vërtetohet se paditësi në bazë të kontratës së shitblerjes të dt.02.09.1972, e lidhur nga paraardhësi i tij A.S. si blerës dhe paraardhësit të të paditurve V.P. e lindur P. si shitëse përkatësisht prej të paditurve si bashkëpronarë juridik S.D. nga ..., 16/30 pjesës ideale, T.S. nga ... 7/30 e pjesës ideale dhe M.R. nga ... 7/30 e pjesës ideale, është pronarë i paluajtshmërisë me nr ... me kulturë pronë private në sipërfaqe prej 290 m<sup>2</sup>, ZK Gjilan, dhe të detyrohen që t'ia pranojnë këtë të drejtë paditësit që të njëjten ta regjistroj pranë DGJKP-ës në Gjilan.

**2.2.** Gjukata me aktvendimin e dt.28.05.2015, e ka aprovuar propozimin e palës paditëse për Caktimin e Masës së Përkohshme të Sigurimit duke i'a ndaluar palës së paditurit ngarkimin në qfardo forme fizike dhe juridike të ngastrës kadastrale me numër ..., në sipërfaqe prej 290m<sup>2</sup>.

**2.3.** Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palëve të paditura u ka dërguar padinë, në mënyrë që të njëjtit të paraqesin përgjigje lidhur me pretendimet e tyre.

**2.4.** Meqenëse palëve të paditura: S.D. nga ..., T.S. dhe M.R., nuk kemi arritur t'ia dorëzojmë padinë në mënyrë të rregullt, pasi në adresën ekzistuese sipas shkresave të lëndës-fletë kthesave, rezulton se të njëjtit nuk jetojnë në atë adresë, gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor në Gjilan, Zyra për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Gjilani, Zyrës së Gjendjes Civile në Gjilan, Qendra për Punë Sociale në Gjilan, sigurimin e adresës dhe vendbanimi e tyre.

**2.4.** Pasi për të paditurit nga institucionet e lartëcekura, nuk ka mundur të sigurohet adresa, me kërkesën e përfaqësuesit të paditësit, gjykata të paditurve, në pajtim me nenin 79.3 pika a dhe 81 të LPK-së, i ka caktuar një përfaqësues të përkohshëm nga radhët e avokatëve, për të mbrojtur të drejtat e tyre, vendim ky i cili, është publikuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe në Gazetën Zyrtare të RKS-së, në pajtim me nenin 83 të LPK-së.

**2.5.** Në përgjigjen në padi përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve avokati A.S., i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

**2.6.** Përfaqësuesi i paditësit A.S., avokati M.A., në seancën përgaditore, kryesore dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ekspertit të gjeodezisë dhe dëshmisë së paraqitur nga ana e dëshmitarëve A.M. dhe H.S. nga ..., si dhe nga deklaratat e noterizuara të trashigimtarëve të paraardhësit të paditësit dhe nga shtjellimi i provave

materiale është vërtetuar se paraardhësi i paditësit tani i ndjeri A.S. në vitin 1972, prej të paditurve e kishte blerë pronën kontestuese dhe pasi që e kishte paguar qmimin e shitblerjes ishte futur në posedim të asaj prone të cilën e posedon prej asj kohe e deri më tani pa u shqetësuar dhe penguar nga askush. Në bazë të asaj vërtetohet se paditësi si trashigimtar i paraardhësit të tij mbi këtë pronë, të drejtën e pronësisë e kishte fituar në bazë të shitblerjes dhe në bazë të parashkrimit fitues dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi në tërsi si të bazuar, shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar dhe ka theksuar se nuk do të parashtrij ankesë kundër aktgjykimit.

**2.7.** Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve avokati A.S. në shqyrtimin përgaditor, kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas shqyrtimit të të gjitha provave materiale të bashkangjitura në padi dhe kërkesëpadi si dhe daljen në vendin e ngjarjes ku u vërtetua sakt gjendja faktike dhe posedimi faktiki paditësit, njashu është vërtetuar nga dëshmitarët I.S. dhe A.M. në seancën e kaluar, se ngastra kadastrale ishte blerë, ishte paguar dhe asnjëher deri më tani nuk ishte penguar nga askush, njashu këtë fakt e ka vërtetuar edhe ekspertiza e ekspertit gjeodet I.S., njashu edhe nga akti noterial ..., ku deklaratdhënësit sipas dispozitivit të deklaratës heqën dorë nga masa trashigimore, andaj nga të lartëcekurat i ka lënë në vëndosje gjykatës dhe ka deklaruar se shpenzimet materiale i ka pranuar në shumë prej 500€.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes së plotë faktike gjykata shtjelloi dhe lexoi provat materiale të propozuara nga palët ndërgjyqëse edhe atë:

- Qertifikata e Vdekjes me numër rendor 178, në emër të A.S. e dt.21.05.2015;
- Kontrata mbi Shitblerjen e Paluajtshmërisë-Shtëpisë e dt.02.09.1972, e lidhur në mes të P.P.si shitës dhe A.S. si blerës;
- Kontrata mbi Mbajtjen e Përherhshme e lidhur me dt.27.09.1966, në mes të S.D. dhe P.P., bashkëshortja e P.S. e lindur V. nga fshati ...;
- Dëftesa mbi pranimin dhe dorëzimin e të hollave e dt.30.10.1972, ku pagues ishte A.S. dhe pranues I të hollave ishte P.P.-shitës;
- Dëftesa e pagesës e dt.10.01.1973. ku shihet se pagues ishte A.S. dhe pranues, ndërsa pranues I të hollave ishte P.P., në shumën prej 150,000.00 dinar;
- Certifikata e Pronës me numër 03174-0, në emër të S.D., T.S. dhe M.R. dhe
- Ekspertiza e dt.18.04.2018, e ekspertit gjeodet I.S..

**3.1.** Në shqyrtimin kryesor të datës 13.06.2018, në cilësi të dëshmitarit A.M. nga ..., ka deklaruar se: sa i kujtohet atij në mes të A.S., tani babait të paditësit A.S. dhe S.D. ishte bërë shitblerja e paluajtshmërisë në të cilën tani është duke jetuar A.S. dhe se kjo shitblerje ishte bërë në vitin 1972, por sakt nuk i kujtohet sepse ka kaluar kohë e gjatë. Shuma nuk i është kujtuar, por që e dinë se

kishte qenë shumë e madhe e të hollave dhe të njejtën e kishte paguar menjëher dhe kishte hyrë të banoj në shtëpi e cila shtëpi kishte qenë shumë e vjetër gati për tu rrënuar. Më tutje dëshmitari ka theksuar se nga koha që kur e kishin blerë e deri më tani A. e shfrytëzon pa qënë i penguar nga askush së bashku me xhaxhain e tij H.. Dëshmitari në atë lagje kishte filluar të banoj para A. gjegjësisht në vitin 1961, dhe se nga koha kur e kishte shitur këtë truall dhe nuk ishte kthyer aty. Dëshmitari ka theksuar më tutje ka theksuar se A. këtë pronë e kishte blerë prej D.T., i cili në atë kohë kishte qenë i moshës 71 vjeçar, në atë shtëpi kishte jetuar vetë sepse kishte qenë i pamartuar dhe nuk kishte pasur fëmijë dhe se në kohën kur dëshmitari kishte filluar të jetoj në atë lagje në fqinsi me S.D. kishte jetuar përafërsisht 11 vite dhe i njëjti shkresen për shitjen e shtëpisë e kishte afishuar në shtëpi dhe ajo shkresë kishte mbetur për një kohë të gjatë deri sa babai i A., A. e kishte blerë dhe se në kohën kur ishte vendosur A. në këtë shtëpi kishte qenë duke jetuar së bashku me vëllaun e tij H.. Më tutje ka deklaruar se në kohën kur e kishin bërë pazar këtë shtëpi nuk kishin përpilu aktformal, por vetëm gojarisht dhe aty kishte qenë i pranishëm babai i tij, tani i ndjerë B.M., A.M., H. dhe dy persona tjerë por të njëjtit tani nuk janë në jet. Tani në këtë shtëpi është duke jetuar A., djali i A., e që tani kjo shtëpi tani është gjysma e vjetër e gjysmën tjetër të shtëpisë e ka rinovuar. Meditjen për dëshminë e dhënë nuk e ka kërkuar.

**3.2.** H.S. nga ..., në cilësi të dëshmitarit, në shqyrtimin kryesor të datës 13.06.2018, ka deklaruar se: pronën në fjalë kishte blerë A.S. i cili ishte vëllau i tij, të njëjten e kishte blerë nga P.V. dhe se kur ishte bërë kjo shitblerje ai kishte qenë prezent, por që kishin qenë edhe disa persona, por se nuk i është kujtuar kush kishte qenë pasi që ka kaluar kohë e gjatë, ku kjo shitblerje ishte bërë para 50 viteve edhe ai jeton në atë shtëpi dhe nga ajo kohë nuk kishin pasur problem me askënd. Më tutje dëshmitari ka deklaruar se kjo pronë në atë kohë ishte blerë me dinar dhe së bashku me vëllezërit e tij e kishin blerë këtë pronë dhe se deri më tani nuk kishin pasur asnjë problem lidhur me shfrytëzimin e kësaj prone as nga ana e Shërbimeve Komunale e as nga Gjykata, nga kohe kur e kishin blerë e deri tani ata e kishin bërë pagesën e të gjitha shpenzimeve komunale dhe të rrymës në emrin e tyre. Nga koha kur e kishin blerë personat të cekur në padi ishin shpërngulur dhe nuk ishin kthyer asnjëher më dhe se nga momenti kur e kishin blerë këtë paluajtshmëri e kishin ndërtuar shtëpinë dhe nuk i kishin penguar askush. Dëshmitari më tutje ka theksuar se në momentin kur e kishin blerë paluajtshmërinë ia kishin dhënë paret që kishin qenë dinar dhe menjëher kishin hyrë në shfrytëzim, fqinjë aty e kishin pasur A. dhe sa i është kujtuar këtë pronë e kishin blerë 28 milion banka dhe paret ia kishin dhënë menjëher dhe nga ajo kohë e deri më tani e kanë shfrytëzuar të qetë dhe të papenguar nga askush. Në kohën kur e kishin blerë këtë paluajtshmëri kishin qenë prezent disa dëshmitarë të cilën edhe kishin bërë proces, por që nuk e din qka ishte shkruar dhe atë dokument e kishte ruajtur A., vëllau i tij, ndërsa tani nuk e dinë se a është ai dokument. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

**3.3.** Sipas konstatimit të ekspertit gjeodet I.S., të datës 16.04.2018, pas vrojtimit të drejtpërdrejtë dhe matjeve të kryera në vendin e ngjarjes në bazë të identifikimit të bërë në prani të gjykatës dhe paditësit dhe përfaqësuesit të paditësit dhe përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurve, sipas Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, përkatësisht Certifikatës mbi të Drejtat e Pronës

së Paluajtshme dhe përpunimit të rezultateve, ka konstatuar se pjesa e përkufizuar e pronës për të cilën kërkohet vërtetimi i të drejtës së pronësisë mban numrin kadastral ..., në sipërfaqe të përgjithshme prej 290 m<sup>2</sup>, e cila evidentohet në emër të të paditurve: D.S., S.T. dhe R.M., me kulturë shtëpi, në vendin e quajtur “ ... ”, parcelë kjo e cila kufizohet në anën veri-perendimore në gjatësi prej 14.55m, me parcelën kadastrale ..., me pronar M.B., në veri-lindje me gjatësi prej 19.94m me parcelën kadastrale ..., e cila në DGJKP evidentohet në emër të S.R., në jug-lindje në gjatësi prej 6.50m, me parcelën kadastrale nr. ..., e cila në DGJKP evidentohet në emër të M.A. gjegjësisht në gjatësi prej 7.64m me parcelën ..., me pronar A.H. dhe në jug-perendim në gjatësi prej 20.64m, përkufizohet me parcelën ..., e cila në DGJKP evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan.

**Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqjese dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e njëjta duhet të aprovet duke vërtetuar këtë gjendje faktike.**

#### **4. Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës**

**4.1.** Se paditësi A.S. nga ..., është pronar i vetëm juridik, në baze të kontratës së shitblerjes, të paluajtshmërisë së kësaj ngastre kadastrale ..., në vendin e quajtur “ ... “, me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 290m<sup>2</sup>, sipas Qertifikatës Pronësore me numër të lëndës ..., e dt.13.03.2015, ZK Gjilan, e cila evidentohet në emër të të paditurve: D.S. si bashkëpronar i pjesës ideale 16/30, S.T. i pjesës ideale 7/30 dhe R.M. e pjesës ideale 7/30, dhe se paluajtshmërinë kontestuese në vitin 1972, babai i tani paditësit A.S. e kishte blerë nga P.V. dhe që nga ajo kohë ka hyrë në posedim të qetë faktik, kur edhe ka bërë pagesën e tërësishme të të hollave sipas marrëveshjes të cilën parcelë e shfrytëzon i papenguar nga askush.

**4.2.** Deri te ky konstatim gjyqtarja erdhi duke u bazuar në provat personale dhe materiale në shkresat e lëndës e të cilat pa mëdyshje vërtetuan gjendjen ekzistuese faktike sikurse paditësi e ka paraqitur në padi, se pronën e lartpërmendur e ka blerë në vitin 1972 dhe për të njëjtën kanë përpiluar edhe aktin formal-kontratën me shkrim të vërtetuar në Gjykatë, kontratë kjo që e vërteton ekzistimin e shitblerjes së kësaj paluajtshmërie, mirëpo këtë fakt e kanë argumentuar edhe përmes dëshmitarëve A.M. dhe H.S. si dhe nga përgjigjja në padi e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurve avokatit A.S., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe fjalën përfundimtare.

**4.3.** Nga përmbajtja e deklaratës së dëshmitarit A.M., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 13.06.2018, gjykata ka konstatuar faktin se A.S. babai i paditësit A.S. dhe S.D. ishte bërë shitblerja e paluajtshmërisë e cila gjindet në ..., në të cilën tani është duke jetuar dhe se kjo paluajtshmeri ishte blerë në vitin 1972, pas dorëzimit të qmimit kontraktues edhe kishin hyrë në posedim të qetë pa u penguar nga askush deri më tani. Në parcelën kontestuese kanë të ndërtuar një shtëpi, pjesa e të cilës njëra është e rinovuar ndërsa pjesa tjetër edhe ajo që ka qenë kur është kryer shitblerja, të

cilën paluajtshmëri e shfrytëzon i pa penguar nga askush deri më tashë. Gjykata këtij dëshmitari i'a fali besimin pasi që ishte konsistent me të thënat e paditësit në padi si dhe ne shqyrtimet gjyqësore.

**4.4.** Gjykata nga dëshmitari H.S. nga ..., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 13.06.2018, gjykata vërtetoi faktin se pronën kontestuese e kishte blerë vëllau i tij A.S. të njëjten e kishte blerë nga P.V. në lartësi prej 28 milion banka dhe se kur ishte blerë kjo paluajtshmëri i njëjti ishte prezent, kjo paluajtshmëri ishte blerë para 50 viteve, ai jeton në atë shtëpi nga koha e shitblerjes pa u penguar nga askush dhe se ajo pronë ishte blerë me dinarë, pronën kontestuese e kishin blerë së bashku me vëllezërit e tij, qmimin shitblerës e kishinë paguarë dhe se nga koha kur e kishin blerë paluajtshmerinë kontestuese nuk janë penguar nga askush po ashtu të njëjtit kishin përpiluar edhe kontratën e shitblerjes me numër ..., të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan. Gjykata edhe këtij dëshmitari i'a fali besimin pasi që i njëjti ishte i drejtpërdrejt e kredibil për gjykatën te thenat e tij ishin konsistente me padinë e paraqitur në këtë gjykatë dhe të thënat e paditësit në shqyrtimet gjyqësore.

**4.5.** Nga qertifikata pronësore me numër ..., të dt.13.03.2015, gjykata vërtetoi faktin se kjo ngastër ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 290m<sup>2</sup> dhe evidentohet në emër të të paditurve: D.S. në pjesën ideale prej 16/30, S.T. në pjesën ideale prej 7/30 dhe R.M., në pjesën ideale prej 7/30.

**4.6.** Nga konstatimi i ekspertit gjeodet i dt.09.06.2004, gjykata konstatoi faktin se sipas incizimit me kordinata gjendja faktike në teren ka një sipërfaqe prej 290 m<sup>2</sup>, e cila është e evidentuar me numër ... ZK ...,Gjilan sipas qertifikatës pronësore me numër. ..., në emër të D.S., S.T. dhe R.M. si bashkëpronarë, të gjithë nga ..., tani me vendbanim të panjohur, paluajtshmëri kjo e cila e cila kufizohet në anën veri-perendimore në gjatësi prej 14.55m, me parcelën kadastrale ..., me pronar M.B., në veri-lindje me gjatësi prej 19.94m me parcelën kadastrale ..., e cila në DGJKP evidentohet në emër të S.R., në jug-lindje në gjatësi prej 6.50m, me parcelën kadastrale nr. ..., e cila në DGJKP evidentohet në emër të M.A. gjegjësisht në gjatësi prej 7.64m me parcelën ..., me pronar A.H. dhe në jug-perendim në gjatësi prej 20.64m, përkufizohet me parcelën ..., e cila në DGJKP evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan..

**4.7.** Gjykata pas analizimit të provave material dhe të cekurave të paditësit në padi si dhe përfaqësuesit të paditësit gjatë shqyrtimeve gjyqësore, gjykata erdhi në përfundim se paditësi paluajtshmerinë në fjalë e kishte blerë nga P.V. e lindur P. si paraardhëse e të paditurve dhe qmimin shitblerës e kishte paguar në tërsi dhe paluajtshmerinë në fjalë paditësi e posedon dhe shfrytëzon pa u penguar nga askush, gjykata po ashtu vërtetoi saktësinë e deklaratave të dëshmitarëve, të cilat përputhen, me të dhënat e kësaj padie dhe kërkesëpadie të paditësit.

**4.8.** Me rastin e konstatimit të gjendjes faktike besimi ju falë provave materiale edhe atë kontratës me numër ..., e lidhur ndërmjet P.P. si shitëse dhe A.S. si blerës e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe deklaramit të përfaqësuesit të paditësit në shqyrtimet gjyqësore i cili deklarim ishte në koherenc edhe më këtë provë materiale.

**4.9.** Ndërsa propozimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurve të cekur në përgjegje në padi, për refuzimin e kërkesë padisë si të pabazuar nuk e aprovoi meqenëse i njëjti përpos që nuk ishte bindës dhe mjaftueshëm i argumentuar, nuk ishte në koherencë me asnjë nga provat e shtjelluara e të cilave kjo gjykatë i fali besimin.

## **5. Dispozitat ligjore të aplikueshme**

**5.1.** Duke u bazuar në nenin 33 të LTHMPJ-së, sipas së cilës ‘’ në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj’’, si dhe në rastin konkret rezulton se paditësi A.S., ka ushtruar pushtetin faktik në mënyrë të drejtpërdrejtë në palujtshmërinë në fjalë, i qetë dhe papenguar nga askush prandaj edhe do të duhet ti njihet edhe pushteti juridik në të njëjtën dhe atë në bazë të kontratës së shitblerjes dhe mbajtjes nga fakti se e ka poseduar në mirëbesim dhe të ligjshëm duke e mbajtur dhe shfrytëzuar palujtshmërinë në vazhdimësi dhe pandërprerë, për periudhë kohore më tepër se 20 vite dhe në pajtim me nenin 28 të LTHMPJ-së<sup>1</sup>, sipas së cilës ‘’Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh’’, prandaj edhe në këtë rast pushteti faktik që paditësi A.S. ka ushtruar në pronën në fjalë, përkatësisht e ka poseduar dhe shfrytëzuar, që nga viti 1972, shëndrrohet në pushtet juridik dhe mbi këtë bazë edhe gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar me ligj.

**5.2.** Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në pajtim me nenin 452 paragrafi 4 të LPK-së

**5.3.** Nga të cekurat e lartshënuara, e bazuar në nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Më datë 13.07.2018**

**G j y q t a r j a**

Mirvete Alidemi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.

---

<sup>1</sup> Meqenëse marrëdhënia është krijuar-ka lindur në kohën kur ka qenë i zbatueshëm Ligji mbi Themelimin e Marrëdhënieve Juridike Pronësore të RSFJ-së të vitit 1980 u zbatua kjo dispozitë.

